

Ruani ushqimet nga minjtë!

Mos përdorni fruta mali të palara sepse mund të sëmureni nga ethet e minjve!

Duke pasur parasysh se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike përcjell situatën epidemiologjike me ethet e minjve, për çdo vit paraqiten raste sporadike, të cilat në Kosovë janë të përhapura, në rajonin e Dukagjinit, rajonin e Karadakut dhe rajonin e Shalës, varësisht nga shumimi i minjve.

Burimi i infeksionit janë minjtë. Sëmundja përhapet me ushqim, me aerosole dhe me kontakt. Rastet me ethe hemorragjike me sindromën renale sporadike janë të palidhura mes veti dhe nuk ka ndonjë shpërthim epidemik mes tyre, por pakujdesi gjatë ruajtjes së ushqimit dhe konsumimi i manave të palara mund të shkaktojë sëmundje vdekjepruese.

Në organizmin e njeriut shkaktari hy përmes tri portave hyrëse: trakti respirator, trakti tretës dhe përmes lëkurës.

Trajtimi i sëmundjes bëhet me sukses të plotë në Klinikën Infektive në qoftë se paraqiten me kohë. Poqese të sëmurët kërkojnë ndihmë me vonesë paraqiten komplikime, e që mund të bllokohen veshkat.

Klinika Interne, gjegjësisht repartet e dializës janë të gatshme që të hemodializojnë përkohësisht pacientët. Ndërsa,

Instituti Kombëtar me laboratorët e vet, e diagnostikon sëmundjen brenda ditës.

Masat parandaluese:

1. Pengimi i futjes së brejtësve në shtëpi dhe stane.
2. Ruajtja e ushqimit nga ekskretet e brejtësve.
3. Përpunimi termik i artikujve ushqimor të dyshimtë
4. Frytet e pyllit mos të konsumohen pa u pastruar
5. Djathit të freskët t'i shtohet kripë dhe mos të konsumohet si i freskët nëse dyshohet se është kontaminuar
6. Gjatë punës në fushë të punohet me maska nëse vërehet shtim të brejtësve
7. Larja e duarve me ujë dhe sapun te kosarët dhe punëtorët tjerë të fushës para ngrënies
8. Mos hidhni mbeturina kudo
9. Të bëhet klorimi i ujit të pijes
10. Zhdukja e vatrave natyrore të brejtësve
11. Dezinfektimi i sipërfaqeve të kontaminuara nga ekskretet e brejtësve.

Ruani ushqimet nga minjtë!

Mos përdorni fruta mali të palara sepse mund të sëmureni nga ethet e minjve!

Duke pasur parasysh se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike përcjell situatën epidemiologjike me ethet e minjve, për çdo vit paraqiten raste sporadike, të cilat në Kosovë janë të përhapura, në rajonin e Dukagjinit, rajonin e Karadakut dhe rajonin e Shalës, varësisht nga shumimi i minjve.

Këtë vit, një rast i raportuar nga Klinika Infektive është në gjendje të rëndë klinike.

Burimi i infeksionit janë minjtë. Sëmundja përhapet me ushqim, me aerosole dhe me kontakt. Rastet me ethe hemorragjike me sindromën renale sporadike janë të palidhura mes veti dhe nuk ka ndonjë shpërthim epidemik mes tyre, por pakujdesi gjatë ruajtjes së ushqimit dhe konsumimi i manave të palara mund të shkaktojë sëmundje vdekjepruese.

Në organizmin e njeriut shkaktari hy përmes tri portave hyrëse: trakti respirator, trakti tretës dhe përmes lëkurës.

Trajtimi i sëmundjes bëhet me sukses të plotë në Klinikën Infektive në qoftë se paraqiten me kohë. Poqese të sëmurët kërkojnë ndihmë me vonesë paraqiten komplikime, e që mund të bllokohen veshkat.

Klinika Interne, gjegjësisht repartet e dializës janë të gatshme që të hemodializojnë përkohësisht pacientët. Ndërsa, Instituti Kombëtar me laboratorët e vet, e diagnostikon sëmundjen brenda ditës.

Masat parandaluese:

1. Pengimi i futjes së brejtësve në shtëpi dhe stane.
2. Ruajtja e ushqimit nga ekskretet e brejtësve.
3. Përpunimi termik i artikujve ushqimor të dyshimtë
4. Frytet e pyllit mos të konsumohen pa u pastruar

5. Djathit të freskët t'i shtohet kripë dhe mos të konsumohet si i freskët nëse dyshohet se është kontaminuar
 6. Gjatë punës në fushë të punohet me maska nëse vërehet shtim të brejtësve
 7. Larja e duarve me ujë dhe sapun te kosarët dhe punëtorët tjerë të fushës para ngrënies
 8. Mos hidhni mbeturina kudo
 9. Të bëhet klorimi i ujit të pijes
 10. Zhdukja e vatrave natyrore të brejtësve
 11. Dezinfektimi i sipërfaqeve të kontaminuara nga ekskretet e brejtësve.
-

Demant nga IKSHPK

Datë 11 korrik 2019

Duke pasur parasysh artikullin në gazetën “Koha Ditore” datë 11 korrik 2019 me titull „Kompania që dyshohet si përgjegjëse për vdekjet nga oksiduli sërish fiton tender për furnizim me gazin mjekësor“, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike lëshon këtë demant:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka nënshkruar kontratën publike kornizë- Furnizim me gaz medicinal me numër identifikues: 711-19-3161-1-2-1 nr. të brendshëm MSH 711-19-003-1-2-1 me furnizuesin NPSHT “Bubeari Komerc” NRB: 80144911 me nr protokoli 834, date 5 korrik 2019 e nënshkruar mes zyrtares përgjegjëse të prokurimit znj Remzije Zhushi dhe drejtorit të NPSHT “Bubeari Komerc” z. Naser Guri.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike kujdeset për shëndetin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe ka mandat të sigurojë hulumtim aktiv të të gjithë faktorëve që rrezikojnë shëndetin e qytetarëve. Këto hulumtime aktive kanë të bëjnë, pos tjerash, edhe në hulumtimin laboratorik të kontrollit të ujit dhe ushqimit që përdoren për konsum të përditshëm të qytetarëve. Për të realizuar këto hulumtime në kuadër të IKSHPK ekziston Qendra e Laboratoreve Testuese që mbikëqyrë dhe analizon faktorët e tillë të riskut për shëndetin e njeriut dhe është i akredituar nga Agjensioni për Akreditim i Kosovës në kryerjen e mbi 200 analizave të ujit dhe ushqimit me standardet europiane ISO 9001 dhe 17025.

Zyra e Prokurimit në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me gas medicinal” nr. i prokurimit: 711-19-988-1-2-1, nr. i brendshëm i prokurimit: MSH711 19 003 121 dhe ecuria e procedures është:

Për këtë aktivitet të prokurimit vendimi për inicimin e procedurave është marrë me datë: 13.03.2019. Njoftimi për kontratë është bërë me datë 13.03.2019, hapja e tenderëve me datë 08.04.2019 dhe në afatin e rregullt për pranimin e ofertave nuk është pranuar asnjë ofertë. Me datë 07.05.2019 është publikuar Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Njoftimi për kontratë ri-tenderim (nr. i

prokurimit 711-19-3161-1-2-1) është bërë me datë 15.05.2019, hapja e tenderëve me datë 10.06.2019 ku është pranuar vetëm një ofertë dhe atë nga Operator Ekonomik NPTSH "Bubeari Komerc". Vendimi i Komisionit për Vlerësimin e ofertave është bërë me datë 12.06.2019. Vlerësimi i ofertës është bërë duke u mbështetur në kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, të cilat janë publike në platformën e-prokurimit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Operatori Ekonomik në fjalë ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se është i përgjegjshëm duke i plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Poashtu vendimi për dhënie të kontratës është marrë pasi NPTSH "Bubeari Komerc" ka sjellë edhe dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë që janë vërtetimi nga Administrata Tatimore dhe çertifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë (Agj.nr. 3459/19 dt. 13 qershor 2019) për qëllime të pjesëmarrjes në tender. Poashtu operatori ekonomik në fjalë ka sjellë në origjinal edhe sigurimin e tenderit.

Mbas plotësimit të kushteve të tenderit, përfshirë kërkesat e përshtatshmërisë dhe të pranueshmërisë, njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues është bërë me datë 25.06.2019. Njoftimi për dhënie të kontratës është publikuar me datë 02.07.2019,

kontrata është nënshkruar me datë 05.07.2019 dhe Njoftimi për nënshkrimin e kontratës është publikuar me datë 08.07.2019.

Duhet pasur parasysh se gazrat që janë objekt i kontratës përdoren në pajisje laboratorike e asesi te pacientët në çfarëdo mënyre (direkte e as indirekte).

Për sqarime eventuale të opinionit bëjmë me dije se:

Në laboratorin organik përdoren këto gazëra:

HELIUMI ne GC-MS (carrier gas) për përcaktimin e Trihalometaneve në ujë.

AZOTI në GC-MS (makeup gas) për përcaktimin e Trihalometaneve në ujë.

Ne laboratorin Inorganik përdoren këto gazëra:

ARGONI si gaz kryesor në përcaktimin e metaleve në ujë dhe ushqim;

HELIUMI si gaz ndihmesë për përcaktimin e metaleve në ujë;

AJRI I kompresuar –për përcaktimin e metaleve në ujë dhe ushqim;

Oksigjeni – për përcaktimin e Pb në gjak me furrë grafite (Absorber Atomik).

Në laboratorin e ujit përdoren këto gazëra:

HELIUMI në Gas Kromatograf (carrier gas) për përcaktimin e pesticideve në ujë;

AZOTI në Gas Kromatograf (makeup gas) për përcaktimin e pesticideve në ujë;

Ajri i kompresuar në aparatin TOC për përcaktimin e karbonit organik dhe karbonit total në ujë.

BUTANI përdoret në të gjitha laboratorët për përgatitje të mostrave që duhet të nxehen apo të digjen varesisht nga procedura.

AZOTI përdoret për përgatitjen e mostrave për përcaktimet kromatografike;

Hidrogjeni- për përcaktimin e pesticideve organiklorine në ujë me FID detektore;

Gazi CO₂ – në laboratorin mikrobiologjik për inkubator për inkubimin e bakterieve.

Të gjitha këto fakte në mënyrën më transparente flasin se nuk ka vend për dyshime të çfarëdo natyre duke marrë parasysh faktin se gazërat e kontraktuar janë gazëra laboratorik dhe asnjëri nuk përdoret për pacientë, po për aparaturën laboratorike, ndërsa sipas dispozitave ligjore në fuqi i plotëson të gjitha kushtet për përdorim. Duhet pasur të qartë se në këtë kontratë nuk ka artikull të gazit oksidul, siç tentohet të atribuohet në përshkrimin e gazetës pa fakte. Njëherit pasi që gazrat e kontraktuara nuk përdoren si preparate mjekësore për pacient nuk ka nevojë leje e posaçme e

AKPM!

Instituti Kombëtar nuk është institucion gjyqësor që të shpallë fajtor apo të pafajshëm. Instituti përmes zyrës së prokurimit nis procedurat me formën më të avancuar me E-Prokurim, i cili proces monitorohet nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRrPP).

Poqese ka dyshime në cilëndo etapë të procedurave të prokurimit e që është në kompetencë të IKSHPK do të ndërmerren masa konform ligjeve në fuqi.

Qytetarë kujdes nga rriqrat!

Rriqrat tashmë kanë filluar të pickojnë!

Kujdesuni nga pickimi i rriqnave sepse ato nuk fluturojnë as nuk i afrohen njerëzve!

Përmbajuni rekomandimeve të Institutit Kombëtar që të mbroheni nga Ethet hemorragjike!

Në vatrat endemike ka filluar pickimi i rriqrave që është paralajmërimi i parë për mundësinë e shfaqjes së sëmundjes. Numri i të pickuarëve ka arritur në **848** në komunën e Malishevës, **342** raste në komunën e Suharekës, **257** raste në komunën e Klinës dhe **125** në komunën e Rahovecit si pasojë e qëndrimit në livadhe të pa kositura, shkurre dhe shtalla dhe veshmbathjes jo adekuate.

Kujdesi duhet të jetë i madh nga qytetarët sepse nga pickimi tashmë nje person është diagnostikuar me ethe hemorragjike me gjendje te përkeqësuar klinike.

Tashmë ekipet profesionale po bëjnë repelimin e kafshëve.

Instituti Kombëtar rekomandon qytetarët për sivjet:

1. Mos qëndroni gjatë dhe pa nevojë në livadhe dhe vende me shkurre,
2. Nëse patjetër duhet të jeni të pranishëm në këto vende vesh rroba të gjata dhe pantallonat futni në çorapë,
3. Duhet të përdorni preparate me të cila lyejmë pjesët e trupit të cilat i dëbojnë insektet nga trupi i njeriut e sidomos në pjesët e zbuluara të trupit, (shuplakat, qafën),
4. Kontrolloni trupin mos keni ndonjë rriqër gjatë qëndrimit në vatër,
5. Kontrolloni përsëri trupin pas largimit nga livadhi apo vendet me shkurre,
6. Nëse keni rriqër në trup ofrohuni në qendrën më të afërt mjekësore sa më shpejt,
7. Kositja e barit të bëhet në vazhdimësi (oborr dhe livadhe),
8. Pastrimi dhe dezinfektimi i stallave të bëhet në vazhdimësi,
9. Mbajtja e higjienës personale në nivelin më të lartë.

**Është mbajtur takim midis
Kolegjit Amerikan të**

Kirurgëve dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike

Prishtinë, 24 qershor, 2019

Është mbajtur takim midis Kolegjit Amerikan të Kirurgëve dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, ku u diskutua rreth aktiviteteve të shëndetësisë publike, dhe bashkëpunimit, me Shëndetësinë Amerikane në të ardhmen.

Në dy vitet e fundit mbi 300 persona humbën jetën në komunikacion

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) shpreh shqetësimin e thellë lidhur me numrin e lartë të aksidenteve të trafikut me fatalitet ku vetëm gjatë pesë muajve të parë të këtij viti kanë humbur jetën mbi 30 persona. Sipas IKSHP, nga 1 janari i vitit 2017, në aksidente rrugore kanë humbur jetën mbi 300 persona, prej tyre 137 kanë vdekur më 2017, 129 më 2018.

Shkaqet janë të ndryshme, por sigurisht se faktori njeri është më i shpeshtë pasi që nuk janë duke u respektuar rregullat e përgjithshme në trafik, por duke mos munguar as faktori rrugë dhe automjet pasi në shumë vende mungojnë shenjat e komunikacionit dhe veturat e vjetra me mangësi të shumta

teknike, thuhet në reagim.

Me këtë rast Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës jep rekomandimet me qëllim të parandalimit të numrit të aksidenteve në trafik:

- Përpilimi i një plani të veprimit për parandalimin e aksidenteve dhe aprovimi me procedura urgjente nga Parlamenti i Kosovës.
- Zbatimi me rigorozitet i Ligjit për komunikacionin deri në ndalesën e vozitjes për shkelje të rënda të përsëritura.
- Me programe të ndryshme edukativo-informative të vetëdijësohen njerëzit e posaçërisht vozitësit për rolin e tyre në parandalimin e aksidenteve të cilat ndodhin si pasojë e gabimeve të tyre si dhe aftësimi për të ofruar ndihmën e parë.
- Angazhimi i mas-mediave në kampanja të ndryshme që kanë për qëllim parandalimin e aksidenteve.
- Me fillimin e vitit të ri shkollor të sensibilizohet çështja e sigurisë së fëmijëve në komunikacion duke organizuar orë edukativo – arsimore për sjelljen e këmbësorëve në komunikacion, mësimi sistematik i rregullave të komunikacionit.
- Largimi i menjëhershëm i automjeteve të vjetra nga qarkullimi, kontrolli teknik rigoroz i të gjitha automjeteve.
- Kontrollimet mjekësore të rregullta, periodike dhe plotësuese me vlerësim rigoroz të shëndetit mendor të vozitësve që kanë bërë shkelje të rënda të njëpasnjëshme.
- Të rregullohet infrastruktura rrugore, të bëhet mirëmbajtja e rrugëve, të kompletohet sinjalizimi dhe respektimi rigoroz i rregullave të parkimit të veturave.
- Drejtuesit e automjeteve t'i përmbahen me përpikëri shenjave të komunikacionit dhe kodit të mirësjelljes qytetare.
- Inspektimi rigoroz i autoshkollave dhe kritereve për marrjen e patentë-shoferëve.
- Këmbësorët të respektojnë shenjat e komunikacionit.

Ekspertët e Institutit Kombëtar alarmojnë dhe paralajmërojnë se nëse nuk merren masa urgjente, humbja e pritshme e jetëgjatësisë së banorëve do të jetë enorme, andaj apelon te të gjithë qytetarët të kenë shumë kujdes gjatë drejtimit të automjeteve, pasi automjeti është armë vrasëse që merr viktimë të pafajshme.

Ministri Ismaili mbledh Këshillin Ndërmnistror për të diskutuar për veprimet e ndërmarra kundër Etheve hemorragjike

Prishtinë, 11 qershor 2019

Nën udhëheqjen e Ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, është mbajtur takimi i radhës i Këshillit ndërmnistror për luftimin dhe parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHCC).

Ministri Ismaili tha se takimi i Këshillit po mbahet me qëllim të përcjelljes sa më të mirë të zbatimit të masave për kontrollin e etheve homorragjike për të ndikuar në uljen e sëmundshmërisë nga kjo sëmundje që shkaktohet si pasojë e pickimit dhe infektimit nga rriqrat.

Ministri Ismaili kërkoi nga të gjitha institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e Planit operativ për parandalimin dhe luftimin e EHCC që ta rrisin angazhimin gjatë kësaj periudhe kur frekuenca e rasteve mund të jetë më e shprehur.

Drejtori i IKSHP-së, Naser Ramadani, tha se në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera po zbatohen aktivitetet e Planit operacional me qëllim të parandalimit dhe luftimit të EHCC, kurse zyrtarë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe nga Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës njoftuan se në terren po bëhet dezinesktimi i hapësirave bashkë me komunat që njihen si zona endemike (Malishëve, Suharekë, Rahovec e Klinë), si dhe repelimi i kafshëve si masë parandaluese.

Këshilli, gjithashtu, u bën thirrje qytetarëve që të kenë kujdes të shtuar gjatë kësaj sezone duke zbatuar masat e përgjithshme për mbrojtjes nga Ethet Hemorragjike, ndërsa në raste të pickimit nga rriqnat të lajmërohen te mjeku më i afërt në kujdesin primar shëndetësor.

Qytetarë kujdes nga rriqrat!

Rriqrat tashmë kanë filluar të pickojnë!

Kujdesuni nga pickimi i rriqnave sepse ato nuk fluturojnë as nuk i afrohen njerëzve!

Përmbajuni rekomandimeve të Institutit Kombëtar që të mbroheni nga Ethet hemorragjike!

Në vatrat endemike ka filluar pickimi i rriqrave që është

paralajmërimi i parë për mundësinë e shfaqjes së sëmundjes. Numri i të përkohshëmve ka arritur në 602 në komunën e Malishevës, 257 raste në komunën e Suharekës, 177 raste në komunën e Klinës dhe 94 raste në komunën e Rahovecit si pasojë e qëndrimit në livadhe të pa kositura, shkurre dhe shtalla dhe veshmbathjes jo adekuate.

Kujdesi duhet të jetë i madh nga qytetarët sepse nga pickimi tashmë një person është diagnostikuar me ethe hemorragjike me gjendje të përkeqësuar klinike.

Tashmë ekipet profesionale po bëjnë repelimin e kafshëve.

Instituti Kombëtar rekomandon qytetarët për sivjet:

1. Mos qëndroni gjatë dhe pa nevojë në livadhe dhe vende me shkurre,
2. Nëse patjetër duhet të jeni të pranishëm në këto vende vesh rroba të gjata dhe pantallonat futni në çorapë,
3. Duhet të përdorni preparate me të cilat lyejmë pjesët e trupit të cilat i dëbojnë insektet nga trupi i njeriut e sidomos në pjesët e zbuluara të trupit, (shuplakat, qafën),
4. Kontrolloni trupin mos keni ndonjë rriqër gjatë qëndrimit në vatër,
5. Kontrolloni përsëri trupin pas largimit nga livadhi apo vendet me shkurre,
6. Nëse keni rriqër në trup ofrohuni në qendrën më të afërt mjekësore sa më shpejt,
7. Kositja e barit të bëhet në vazhdimësi (oborr dhe livadhe),
8. Pastrimi dhe dezinfektimi i stallave të bëhet në vazhdimësi,
9. Mbajtja e higjienës personale në nivelin më të lartë.



Lusim RTK dhe mediat elektronike të emitojnë filmin për ethet hemorragjike.

[Rekomandime për Ethet Hemorragjike Krime Kongo](#)

Rekomandime për Ethet Hemorragjike Krime Kongo Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës po përcjell në mënyrë permanente situatën epidemiologjike me Ethet Hemorragjike Krime-Kongo në të gjitha vatrat e infeksionit dhe bashkë me mjekët dhe punëtorët shëndetësor të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, Rahovec, Klinë, Suharekë, Gjakovë edhe sivjet do të vazhdojnë mbikëqyrjen dhe hulumtimin epidemiologjik të të gjitha vatrave, përfshirë

këtu edhe vatrat endemike të komunave fqinje: Lipjan, Drenas, Skenderaj, Prizren, Dragash. Instituti Kombëtar tashmë është në gjendje gadishmërie për të ndërmarre masat profilaktike dhe kundërepidemike për të parandaluar epideminë e EHCC të planifikuar me kohë dhe të përfshira në Planin Operacional për parandalimin dhe luftimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo në Kosovë. Duke pasur parasysh se që nga viti 2013 nuk është shënuar asnjë rast fatal me EHCC pasi që kemi realizuar me sukses masat profilaktike dhe kundërepidemike, ne duhet të vazhdojmë realizimin e aktiviteteve në terren sepse kemi të bëjmë me një sëmundje endemike, vdekjeprurëse dhe praninë e rriqrave në vatrat endemike të cilat bartin virusin e EHCC. Edhe pse rreziku nga etheve hemorragjike është më i vogël se vitet e kaluara, qytetarëve u bëhet apel që edhe më tutje të vazhdojnë të kenë kujdes nga pickimet e rriqrave, sidomos në zonat Malishevë, Rahovec, Suharekë dhe Klinë pasi që tashmë temperaturat kanë filluar të ngriten dhe rriqrat kanë filluar të dalin në sipërfaqe të tokës. Laboratorët e Institutit Kombëtar janë të përgaditura dhe të gatshme për diagnostikimin e të gjitha rasteve të dyshimta në EHCC. Instituti Kombëtar rekomandon qytetarët për sivejt: 1. Mos qëndroni gjatë dhe pa nevojë në livadhe dhe vende me shkurre, 2. Nëse patjetër duhet të jeni të pranishëm në këto vende vesh rroba të gjata dhe pantallonat futni në çorapë, 3. Duhet të përdorni preparate me të cilat lyejmë pjesët e trupit të cilat i dëbojnë insektet nga trupi i njeriut e sidomos në pjesët e zbuluara të trupit, (shuplakat, qafën), 4. Kontrolloni trupin mos keni ndonjë rriqër gjatë qëndrimit në vatër, 5. Kontrolloni përsëri trupin pas largimit nga livadhi apo vendet me shkurre, 6. Nëse keni rriqër në trup ofrohuni në qendrën më të afërt mjekësore sa më shpejt, 7. Kositja e barit të bëhet në vazhdimësi (oborr dhe livadhe), 8. Pastrimi dhe dezinfektimi i stallave të bëhet në vazhdimësi, 9. Mbajtja e higjienës personale në nivelin më të lartë, Instituti Kombëtar bënë thirrje te qytetarët se duhet të punojnë në faktorët e përmirësimit të ekosistemit që nënkupton: 1. Të punohen të gjitha tokat e punueshme, 2. Të kositen të gjitha livadhet me

kohë dhe nga disa herë, 3. Të pastrohen kopshtet dhe pronat për rreth shtëpive, 4. Të pastrohen fermat ku mbahen bagëtitë dhe të largohen rriqrat nga trupi i kafshëve,5. Të kihet kujdes në veshmbathje për të gjithë fermerët dhe anëtarët e tyre të familjeve që punojnë në fushë ku kurrësi nuk guxohet të lihen këmbët e zbathura6. Fëmijët mos të lejohen të luajnë në livadhe e kopshte të pakositura dhe në mbrëmje të kontrollohet prania e rriqrave në tërë trupin.

Posted by [Instituti Kombëtar I Shëndetësisë Publike të Kosovës](#) on Tuesday, 5 March 2019

Nën moton “Duhani dhe shëndeti i mushkërive”, shënohet Dita Botërore pa duhan

Prishtinë, 31 maj, 2019

Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, u shënuar 31 Maji-Dita Botërore pa Duhan, me ç’rast u tha se qëllimi i kësaj dite është rritja e ndërgjegjësimit lidhur me rreziqet që sjell konsumi i duhanit, si dhe avokimi për ndërmarrjen e politikave efektive me qëllim uljen e konsumit të tij, si dhe të inkurajojnë reduktimin e prodhimit dhe konsumit të duhanit.

Drejtori ekzekutiv i IKSHPK-së, Prof. Dr. Naser Ramadani tha se kjo fushatë ndërgjegjësuese ka për qëllim të theksojë lidhjet midis përdorimit të produkteve të duhanit, kontrollit

të tij, dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

“Në hulumtimin e fundit të Global Youth Tobacco Survey-GYTS në Kosovë: prevalenca e përdoruesve aktualë të duhanit në mesin e të rinjve (13-15 vjeç) krahasuar me hulumtimin e kaluar (GYTS 2004) nga 6.7% është ulur në 4.4% (2016), ndërkohë që ekspozimi ndaj tymit të duhanit brenda ndonjë ambienti është ulur nga 84% në 43%, derisa prevalenca e përdoruesve aktualë të duhanit në mesin e të rinjve, krahasuar me hulumtimin e kaluar është nga 10.4% në 8.8%”, shpjegoi Prof. Ramadani.

Koordinatori Shtetëror për Kontrollin e Duhanit, Dr. Faik Hoti prezantoi pakon e masave për kontroll të duhanit, pjesë e FCTC/OBSH, si: monitorimi i përdorimit të duhanit dhe politikat e parandalimit, mbrojtja nga përdorimi i duhanit, ofrimi i ndihmës për lënien e duhanit, paralajmërimet për rreziqet nga duhani, fuqizimi i ndalimit të reklamave, promovimit dhe sponsorimit, dhe rritja e taksave të duhanit.

Në këtë prezantim, u tha se rezultatet nga studimi STEPS (2012) tregojnë se 28.4% e qytetarëve të anketuar në Kosovë janë duhanpirës (37.4% meshkuj, dhe 19.7% femra).

Në njërën nga pakot “Fuqizimi i ndalimit të reklamave, promovimit dhe sponsorimit”, u tha se ndalimi i plotë i reklamave, promovimit dhe sponsorizimit të duhanit mund të ulë konsumin e duhanit me një mesatare prej rreth 7%, dhe se vetëm 37 vende (përfshirë edhe Kosovën), që përfaqësojnë 15% të popullsisë botërore, kanë ndaluar plotësisht të gjitha format e reklamimit, promovimit dhe sponsorizimit të duhanit.

Drejtoresha e klinikës së Pulmologjisë, Dr. Rukije Mehmeti tha se janë dëshmitarë se duhanpirja shkakton sëmundje të ndryshme të mushkërive, dhe se numri i pacientëve me sëmundje obstruktive kronike është i shtuar. Po ashtu, ajo tha se nga duhanpirja vuajnë edhe duhanpirësit pasivë, e veçanërisht fëmijët, të cilët sipas saj, në të ardhmen mund të kenë pasoja serioze.

Ibrahim Tërshnjaku, shef i Inspektoratit Sanitar të AUV, tha se përmes angazhimeve dhe përpjekjeve që ka bërë ky inspektorat përgjatë këtyre viteve, kanë arritur që me përqindje të lartë, të bëjnë zbatimin e dispozitave ligjore, por sipas tij, kanë pasur edhe rënie të dispozitave ligjore, ku Ligji për Duhanin shpesh nuk zbatohet në disa kafene në Kosovë.

„Mos-zbatimi i këtij ligji nga ana e zyrtarëve të lartë shtetëror, inspektorët e punës, arsimit, shëndetësisë, e kanë zbehur në disa dispozita, çështjen e zbatueshmërisë së ligjit të Duhanit”, theksoi ai.

Arben Lila-Përfaqësues i organizatës KADC, tha se bilanci i zbatimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, në vitin e kaluar, sipas tij fatkeqësisht është negativ.

“Raporti i publikuar i progresit për Kosovën, ka thënë se Kosova ka një Ligj gjithëpërfshirës të kontrollit të duhanit, por niveli i zbatimit të tij, ka vazhduar të bie, kjo për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe performancës së dobët të autoriteteve për zbatimin e tij”, tha mes tjerash ai.

ETHET HEMORRAGJIKE EBOLA

Sëmundja njihet edhe me emrat ethet hemorragjike afrikane (African hemorrhagic fever), ethet hemorragjike virale Ebola (Ebola virus, hemorrhagic fever). Ethet hemorragjike Ebola (EHE) është sëmundje jashtëzakonisht e rëndë që në 90% të rasteve përfundon me vdekje.

Origjina e virusit është e panjohur, por sipas të dhënave të

deritanishme, lakuriqët e pemëve janë rezervoar të virusit.

Historiku: Sëmundja për herë të parë është lajmëruar në vitin 1976 në provincën ekuatoriale të Zaires, 350 km larg nga Sudani. Sëmundja karakterizohet me shpërthim të vrullshëm dhe rrjedhë fatale për shkak të infeksionit brendahospitalor të një numri të pacientëve me anë të shiringave të kontaminuara me virus (i njëjti shiringë është përdorur te disa pacientë). Sëmundja më pas lajmërohet në po të njëjtin rajon, por tani në Sudan në vitin 1979. Në vitin 1989, virusi Ebola u izolua nga majmunët *Macaca Fuscicularis*. Epidemia më e madhe e kësaj sëmundje është regjistruar në vitin 1995 në provincën Kitwit të Zairesë ku numri i të sëmurëve arriti në 230, ndërsa numri i të vdekurëve në 160. Gjatë vitit 1996-1997 në Gabon janë regjistruar dy valë të epidemisë me 98 të sëmurë dhe 66 të vdekur, me shkallë të letalitetit 66.7%.

Përhapja gjeografike: prej kohës kur janë regjistruar rastet e para të sëmundjes deri më sot sëmundja nuk ka dalur jashtë vatrave të saja natyrore. Sëmundja është e pranishme në shtetet e Afrikës Perendimore dhe Qendrore: Zaire, Sudan, Gabon, Republikën Demokratike të Kongos, Sierra Leone, Guinea, Liberia, Nigeria etj. Aktualisht ka shpërthyer epidemi në Kongo.

Etiologjia: sëmundja shkaktohet si pasojë e infeksionit me virusin Ebola (emri Ebola rrjedhë nga lumi me po të njëjtin emër në Republikën Demokratike të Kongo-së në Afrikë, ku është paraqitur për herë të parë). Virusit është një nga dy anëtarët e familjes ARN të quajtur Filoviridae. Janë identifikuar katër subtype. Tri prej katër këtyre subtypeve kanë shkaktuar sëmundjen ndër njerëz: Ebola-Zaire, Ebola-Sudan dhe Ebola-Bregu i Fildishtë-Gabon. Subtipi i katërt, Ebola-Reston ka

shkaktuar sëmundjen ndër gjitarë, por jo edhe ndër njerëz.

Inkubacioni: periudha e inkubacionit sillet prej 2-21 ditë. Sipas disa shënimeve edhe nga 3-7 ditë.

Pasqyra klinike: fillimi i sëmundjes është i papritur dhe me shenja jo karakteristike. Shenjat e sëmundjes i ngjasojnë gripit: ethe, plogështi, dhembje muskulore, kokëdhembje, konjuktivit dhe bradikardi. Sëmundja karakterizohet me zhvillim dhe përparim të shpejtë me ç'rast rritet dhembja muskulare dhe ajoe barkut. Te disa pacientë zhvillohet edhe ekzantema. Në fazën e zhvillimit të plotë të sëmundjes paraqitet: diarrea, vjellja, gjakderdhja në lëkurë dhe mukoza (petechie dhe purpura), nga hunda, trakti gastro-intestinal, uro-gjenital, me gjendje shoku.. Te shtatzënat paraqitet metrorragjia dhe aborti. Diateza hemorragjike në të shumtën e herëve shoqërohet me disfunkcion të mëlçisë, insuficiencë të veshkave si dhe dëmtim të sistemit nervor qendror. Në 90% të rasteve, sëmundja përfundon me vdekje.

Periudha e infektueshmërisë: zgjatë sa është i pranishëm virusi në gjakun dhe sekretet e pacientit. Tek rastet laboratorike, virusi Ebola është izoluar edhe në ditën e 61 pas fillimit të sëmundjes. Pas ditës së 72 të fillimit të sëmundjes, virusi Ebola nuk është izoluar nga rastet e provokuara në mënyrë laboratorike.

Diagnoza: vendoset mbështetur në pasqyrën klinike, të dhënat epidemiologjike dhe analizat laboratorike. Analizat laboratorike flasin për limfopeni, trombocitopeni të rëndë, rritje të transaminazave e ndonjëherë edhe hiperamilazemi.

Sëmundja, poashtu diagnostifikohet edhe përmes mikroskopisë elektronike, izolimit të virusit dhe reaksioneve serologjike (ELISA, reaksioni i lidhjes së komplementit, PCR). Antitruptat lajmërohen në gjak, ndërmjet ditës së 7-10 të infeksionit dhe në këtë kohë mund të izolohen.

Diagnoza diferenciale: për diagnozë diferenciale merren parasysh të gjitha sëmundjet hemorragjike virale: ethja hemorragjike Krime Kongo, ethja hemorragjike me Sindrom Veshkor, ethja Denge, ethja e Verdhë etj.

Mjekimi: të sëmurët me pasqyrë klinike të rënd kërkojnë edhe mjekim intensiv. Pacientët janë të dehidruar dhe kërkojnë rehidrim oral dhe intravenoz me tretje që përmbajnë elektrolitë. Nuk ka mjekim specifik për sëmundjen. Njihen rastet kur pacientët janë të mjekuar pas trajtimit me Ribavirin.

Rezervoar i shkaktarit të infeksionit: shkaktari i sëmundjes është gjetur të jetë i pranishëm në: minjtë, lakuriqët e pemës dhe majmunët.

Burim i infeksionit: njeriu infektohet me virusin Ebola në rast të kontaktit të afërt me gjakun, sekretet, organet dhe lëngjet tjera trupore të kafshëve të infektuara. Në Afrikë, infeksioni shkaktohet si pasojë e manipulimit të shimpanza, gorilla, lakuriqë, antilopë dhe kafshë tjera të infektuara. Personi i cili infektohet me virusin Ebola gjatë kontaktit me kafshë bëhet infeksioz për personat e tjerë sidomos gjatë periudhës së gjakderdhjes.

Rrugët e përhapjes: infeksioni bartet përmes kontaktit të afërt me gjakun, sekretet, organet dhe lëngjet tjera trupore të kafshëve të infektuara (nga kafshët në njeri). Infeksioni nga njeriu në njeri bartet përmes: gjakut, lëngjeve trupore dhe ekskreteve (fecesit, urinës, pshtymës, spermës të personit të infektuar. Infeksioni mund të bartet edhe kur personi i shëndoshë, por me lëkurë të dëmtuar të duarve vjen në kontakt me ambientin e kontaminuar me lëngjet trupore të pacientit.

Porta hyrëse: është e lidhur drejtpërdrejt me mënyrë e përhapjes së sëmundjes: mukozat e dukshme, trakti respirator dhe lëkura e lënduar.

Ndjeshmëria: është e përgjithshme, prandaj nga sëmundja, sëmuren të gjithë pavarësisht moshën, gjininë, racën, profesionin, përkatësinë kombëtare etj.

Imuniteti: nuk dihet me saktësi se sëmundja a len imunitet dhe sa zgjatë pas kalimit të saj.

Sezona: sëmundja më së shpeshti paraqitet gjatë muajve të verës.

Masat parandaluese dhe kontrolluese: janë në përputhje me grupet e rrezikut të identifikuara. Më të rrezikuarit nga sëmundja janë:

- Gjuetarët të cilët mund të vijnë në kontakt me kafshët e infektuara të ngordhura,

- Anëtarët e familjes së personave të infektuar,
- Punëtorët shëndetësor,
- Personat që kryejnë ritet fetare dhe të varrimit të pacientëve të vdekur nga Ebola.

Masat parandaluese dhe kontrolluese konsistojnë në:

- Zvogëlimin e kontaktit me kafshët e infektuara (gjalla apo ngordhura),
- Ikjes së kontaktit të drejtpërdrejt me personat e infektuar,
- Izolimi i të sëmurve dhe të dyshimtëve në sëmundje,
- Përdorimi i rrobave mbrojtëse gjatë kontaktit me të sëmurin (maskat, kapelat, dorëzat, mantilat, syzat),
- Përdorimi i gjilpërave vetëm për një përdorim,
- Hulumtimi dhe mbikqyrja e vazhdueshme e personave të kontaktit,
- Dezinfektimi permanent i sipërfaqeve që janë në kontakt me të sëmurin,
- Abstenimi seksual,
- Personat që kryejnë ritet fetare dhe të varrimit të pacientëve të vdekur nga Ebola duhet të kenë rroba mbrojtëse.